



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

Nr. 8392 | prot.
12

Tiranë, më 18.12.2023

URDHËR

Nr. 2414, datë 18.12.2023

PËR

**PROCEDURAT DHE KRITERET E VLERËSIMIT FIZIKO-SHËNDETËSOR TË
KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR USHTARË/DETARË AKTIVË,
APLIKANTËVE PËR TË NDJEKUR STUDIMET NË SHKOLLAT USHTARAKE
BRENDA DHE JASHTË VENDIT, SI DHE PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QË DËRGOHEN ME MISION
JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të germës “f” dhe “nj”, të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar; germës “c”, të nenit 4, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

URDHËR O J:

1. Pranimi i kandidatëve që aplikojnë për t’u pranuar si ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura, aplikantëve që konkurrojnë për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit, si dhe dërgimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me misione jashtë vendit, bëhet pas vlerësimit të gjendjes fiziko-shëndetësore nga Komisioni Mjekësor i Njësisë Mjekësore Ushtarake (NJMU) në Spitalin Universitar të Traumës.
2. Kandidatët që aplikojnë për të hyrë si ushtarë/detarë aktivë dhe aplikantët për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit, duhet të kenë gjatësi jo më e vogël se 165 cm për meshkujt dhe jo më e vogël se 160 cm për femrat.
3. Komisioni Mjekësor i NJMU-së, përpara vlerësimit të gjendjes fiziko-shëndetësore dhe të kryerjes të vizitës mjekësore të përgjithshme, duhet të disponojë për çdo kandidat, vizitat specialiste dhe laboratorike, si më poshtë:

3.1. Për pranimin e kandidatëve që do të aplikojnë për të hyrë ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura:

✓ 3.1.1. Këqyrja fizike e përgjithshme.

✓ 3.1.2. Ekzaminim radiografik të toraksit në dy projeksione, me qëllim përjashtimin e sëmundjeve të mosnjohura, ekzistenca e të cilave mund të jetë me pasoja për individin dhe komunitetin e Forcave të Armatosura.

3.1.3. Vizitat: pneumologu; kardiologu (të shoqëruara me EKG kur nga mjeku kardiolog ka dyshime për ndonjë patologji të mundshme); okulist; otorinolaringolog; psikiatër; neurolog; psikolog; alergolog; endokrinolog; infeksionist; gastrohepatolog; vizitë për aparatën osteo-artro-muskular superior dhe inferior, vizitë kirurgu.

3.1.4. Analizat e urinës për përdorim të substancave narkotike, analizat për agjentë infektivë (anti HBV, HBC), HIV, sifiliz, si dhe analizat e gjakut të cilat duhet të përmbajnë: gjak komplet, glicemi, kreatinemia, transamina (SGPT-SGOT), bilirubina totale dhe e fraksionuar, G6PDH (metoda kuantitative).

3.2. Për pranimin e kandidatëve që do të aplikojnë për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake brenda dhe jashtë vendit:

3.2.1. Këqyrja fizike e përgjithshme.

3.2.2. Ekzaminim radiografik të toraksit në dy projeksione, me qëllim përjashtimin e sëmundjeve të mosnjohura, ekzistenca e të cilave mund të jetë me pasoja për individin dhe komunitetin e Forcave të Armatosura.

3.2.3. Vizitat: pneumologu; kardiologu (të shoqëruara me EKG kur nga mjeku kardiolog ka dyshime për ndonjë patologji të mundshme); okulist; otorinolaringolog; psikiatër; neurolog; psikolog; alergolog; endokrinolog; infeksionist; gastrohepatolog; vizitë për aparatën osteo-artro-muskular superior dhe inferior, vizitë kirurgu.

3.2.4. Analizat e urinës për përdorim të substancave narkotike dhe analizat për agjentë infektivë (anti HBV, HBC), HIV, sifiliz, dhe analizat e gjakut të cilat duhet të përmbajnë: gjak komplet; glicemi; kreatinemia; transamina (SGPT-SGOT); bilirubina totale dhe e fraksionuar; G6PDH (metoda kuantitative).

3.2.5. Fusha vizive të jetë jo më e vogël se 16/10 së bashku dhe jo më e vogël se 3/10 në syrin që shikon më pak edhe me korreksion.

3.2.6. Astigmatizmi mos të jetë më i madh se plus/minus 3, miopia jo më e madhe se plus/minus 5.

3.3. Kontrolli i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që do të shkojnë me misione jashtë vendit:

3.3.1. Këqyrja fizike e përgjithshme.

3.3.2. Ekzaminim radiografik të toraksit.

3.3.3. Vizitat, pneumologu; kardiologu; okulisti; otorinolaringologu; psikiatri; neurologu; psikologu; alergologu; endokrinologu; infeksionisti; gastrohepatologu; vizitë kirurgu.

3.3.4. Analizat e urinës për përdorim të substancave narkotike, analizat për sëmundje infektive, (sëmundja e hepatitit, imunodeficiencës së fituar, sifiliz), si dhe analizat e gjakut të cilat duhet të përmbajnë: gjak komplet, glicemi, kreatinemia, transamina (SGPT-SGOT) dhe bilirubina totale dhe e fraksionuar.

4. Për personelin e Forcave të Armatosura (pika 3.2.) që do të dërgohet me mision jashtë vendit, analizat për sëmundje infektive do të kryhen pranë laboratorëve biokimikë dhe bakteriologjikë të Forcave të Armatosura (NJMU dhe/ose FT). Për rastet që rezultojnë pozitiv me sëmundshmëri infektive, edhe në mënyrë të përsëritur, si rezultate përfundimtare do të merren ekzaminimet biokimike për sëmundje infektive të kryera në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut dhe/ose Institutin e Shëndetit Publik Tiranë si qendra kombëtare të referencës.
5. Analizat për HBS dhe markuesit, HIV, sifiliz për kandidatët për ushtarë/detarë aktivë (pika 3.1.), kandidatët që aplikojnë për të hyrë në shkollat ushtarake brenda dhe jashtë vendit (pika 3.2.), të kryhen pranë drejtorive rajonale të operatorit të kujdesit shëndetësor, institucioneve të tjera shëndetësore shtetërore (bankat e gjakut nëpër rrethe), institucionet mjekësore private të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kryerjen e ekzaminimeve për agjentë infektivë dhe/ose Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Instituti i Shëndetit Publik Tiranë si qendra kombëtare të referencës.
6. Komisioni Mjekësor i NJMU-së mund të kërkojë gjithashtu dhe kryerjen e disa vizitave të tjera specialistike, instrumentare ose laboratorike në rastet kur kërkohen për qartësimin e diagnozës.
7. Komisioni Mjekësor i NJMU-së duhet të parashikojë që për çdo konkurrent të përcaktojë sipas kriterëve që përmbahen në "Rregulloren e Aftësive Fiziko-Shëndetësore të Shtetasit dhe Ushtarakut të Forcave të Armatosura", profilin shëndetësor me karakteristikat somato-funksionale që ka individi, përveç kërkesave specifike të kërkuara në pikën 3.1., 3.2. dhe 3.3. të këtij urdhri.
8. Pas verifikimit të kryer, Komisioni Mjekësor i NJMU-së duhet t'i komunikojë konkurrentit vendimin e komisionit mjekësor, ai/ajo është:
 - 8.1. "i aftë" për t'u pranuar si ushtar/detar aktiv, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake, apo për misione jashtë vendit".
 - 8.2. "i paafte" për t'u pranuar si ushtar/detar aktiv, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake, apo për misione jashtë vendit", duke i qartësuar motivin për vendimin e komisionit.

9. Do të gjykohen “të aftë” për t’u pranuar si ushtarë/detarë aktivë, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake, apo për misione jashtë vendit, duke i qartësuar motivin për vendimin e komisionit, ata që zotërojnë kërkesat e përshkruara në pikën 3.1., 3.2. dhe 3.3. të këtij urdhri, si dhe të gjitha kriteret që përmbahen në “Rregulloren e Aftësive Fiziko-Shëndetësore të Shtetasit dhe Ushtarakut të Forcave të Armatosura”, me karakteristikat somato-funksionale: psiqike, konstitucionale, aparatit kardiovaskular, aparatit respirator, aparateve të ndryshme, aparatit osteo-artro-muskular superior dhe inferior.
10. Do të gjykohen “të paaftë” për ndjekjen e shkollave ushtarake/ushtarë profesionistë/efektivë për mision”, ata që nuk zotërojnë kërkesat e përshkruara në pikën 3.1., 3.2. dhe 3.3. të këtij urdhri dhe kriteret që përmbahen në “Rregulloren e Aftësive Fiziko-Shëndetësore të Shtetasit dhe Ushtarakut të Forcave të Armatosura”, si dhe ata që kanë probleme të tjera, si:
 - 10.1. Çrregullime të të folurit qoftë edhe formës së lehtë (dislalia-disartria).
 - 10.2. Pozitivë ndaj ekzaminimeve laboratorike për abuzim me alkool, për përdorim, edhe pse të përkohshëm ose rastësor të substancave narkotike, përdorim të substancave psikotrope me qëllim jo terapeutik.
 - 10.3. Mbetje të keratotomisë radiale, mbetje të laser-terapisë korrektuese në prani të alterimeve korioretinike ose të lezioneve evidente korneale.
11. Nëse gjatë kryerjes së kontrollit mjekësor individit preket nga sëmundje ose dëmtime akute, të cilat shkencërisht nga ana mjekësore mund të mjekohen për një periudhë kohore prej 45 ditësh nga dita e dëmtimit dhe nuk lënë pasoja në shëndetin e individit, Komisioni Mjekësor i NJMU-së duhet të shtyjë gjykimin, duke caktuar një datë tjetër për të përcaktuar “aftësinë” ose “paaftësinë” e individit.
12. Në rastet kur kandidatët do të konkurrojnë për të kryer shkolla ushtarake për armët speciale (aviacion, marinë) do të ndiqen të gjitha procedurat e duhura sipas specifikimeve që përmbahen në pikën 3.2. të këtij urdhri dhe rregulloreve mjekësore për këto armë.
13. Në rast të nxjerrjes pozitiv të testit të shtatzënisë, Komisioni Mjekësor i NJMU-së në asnjë rast nuk mund të vazhdojë kontrollin mjekësor të parashikuar dhe duhet të heqë dorë nga gjykimi, sipas së cilës gjendja e shtatzënisë përbën një paaftësi të përkohshme fiziologjike për t’u pranuar si ushtar/detar aktiv, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake apo për misione jashtë vendit.
14. Gjykimi i përcaktuar nga Komisioni Mjekësor i NJMU-së është përfundimtar dhe në këto kushte kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar si ushtarë/detarë aktivë, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake, apo për misione jashtë vendit, të gjykuar “të paaftë” nuk duhet të paraqiten përsëri.
15. Gjykimi i shprehur nga Komisioni Mjekësor i NJMU-së është përfundimtar dhe duhet t’i komunikohet kandidatit që aplikon për t’u pranuar si ushtar/detar aktiv, për të ndjekur shkolla apo akademitë ushtarake, apo për misione jashtë vendit, Qendrës së Personel-

Rekrutimit, Akademisë së Forcave të Armatosura, njësisë për efektivin që do të dërgohet me mision, Drejtorisë së Personelit dhe Drejtorisë së Inspektoratit të Shëndetësisë në SHPFA.

16. Pikat 5.5.2. dhe 5.5.3., e udhëzimit të ministrit të Mbrojtjes nr. 5, datë 10.10.2022 “Për procedurat dhe kriteret e rekrutimit të ushtarëve/detarëve aktivë në Forcat e Armatosura” dhe urdhri i ministrit të Mbrojtjes nr. 573, datë 16.12.2005 “Për procedurat e vlerësimit fiziko-shëndetësor të kandidatëve që aplikojnë për të ndjekur studimet në shkollat ushtarake brenda dhe jashtë vendit, kandidatëve që aplikojnë për ushtar profesionist, personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë që shkojnë me misione jashtë vendit”, shfuqizohen.
17. Përgjigjen për zbatimin e këtij urdhri komandat e forcave/atyre mbështetëse, Qendra e Personel-Rekrutimit, Akademia e Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë dhe Njësia Mjekësore Ushtarake (Spitali Universitar i Traumës).
18. Ndjek zbatimin e këtij urdhri Inspektorati i Shëndetësisë në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Niko Peleshi
